



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.975/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “KAV-E-GROUP” Sh.p.k me seli në rr. Racaku p.n - Ferizaj, me NRB: 811389073 ndaj debitorit “Full Petrol” Sh.p.k me seli në Gadime e Ulët nr.3 - Lipjan, me NRB: 811395426 të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat A.S me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.589/2021 të datës 29.10.2021 të Përmbartuesit Privat Sheremet H. Livoreka me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 12.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Full Petrol” Sh.p.k, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.589/2021 të datës 29.10.2021 të Përmbartuesit Privat Sheremet H. Livoreka, për pjesën e detyrimit në shumën prej 860.00€ sipas pagesave të pjesshme të kryera nga debitori.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Full Petrol” Sh.p.k ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.589/2021 të datës 29.10.2021 të Përmbartuesit Privat Sheremet H. Livoreka, sa i përket shumës prej 640.00 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “KAV-E-GROUP” Sh.p.k, ndaj debitorit “Full Petrol” Sh.p.k sipas urdhrit P.nr.589/2021 të datës 29.10.2021, për pjesën e detyrimit në shumën prej 860.00 €.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “KAV-E-GROUP” Sh.p.k, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.589/2021 të datës 29.10.2021, me të cilin ka lejuar

përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave me nr. 120/21 e dt. 15.10.2021, nr.106/21 e dt. 15.09.2021, nr.95/21 e dt.16.08.2021, nr.82/21 e dt. 15.07.2021, nr.67/21 e dt.15.06.2021, nr.54/21 e dt.15.05.2021, nr.43/21 e dt.15.04.2021, nr.30/21 e dt. 15.03.2021, nr.17/21 e dt.15.02.2021, nr.4/21 e dt. 15.01.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave shumë prej 940.00 € duke përfshirë edhe pagesën e kamatëvonesave në vlerë prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura e cila është bashkëngjitur si dokument i besueshëm nuk i përmban elementet e një dokumenti të besueshëm sipas LPP-së ngase e njëjta nuk është pranuar dhe si e tillë nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Tutje thekson se përkundër se në propozimin për përmbartim janë të përfshira edhe faturat e panënskruara të muajit mars, maj dhe korrik 2021, kreditori i ka paguar ato fatura dhe dëshmitë e pagesave të bashkëngjitur në prapësim. Andaj duke u bazuar në gjendjen faktike i propozon Gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi, të anulohet urdhri përmbartimor si dhe të detyrohet kreditori t'ia mbulojë të gjitha shpenzimet e procedurës konform OAK-së në afat prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkak të si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbartuesit Privat Sheremet H. Livoreka, sipas faturave të bashkëngjitura dhe është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga transferet bankare me nr. .... të datës 17.03.2021 në shumë prej 450.00 €, nr. ... të datës 15.05.2021 në shumë prej 150.00 € dhe nr.00012479 të datës 05.07.2021 në shumë prej 260.00 € të cilat gjendet në shkresat e lëndës.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.8 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që kredia që rrjedhë nga dokumenti i besueshëm në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, është shuar pjesërisht përmes përmbushjes së pjesërishtme nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat P.nr.589/2021 të datës 29.10.2021, për pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 640.00 € për faktin se dokumenti i besueshëm – fatura, nr. 120/21 e dt. 15.10.2021, nr.106/21 e dt. 15.09.2021, nr.95/21 e dt.16.08.2021, nr.82/21 e dt. 15.07.2021, nr.67/21 e dt.15.06.2021, nr.54/21 e dt.15.05.2021, nr.43/21 e dt.15.04.2021, nr.30/21 e dt. 15.03.2021, nr.17/21 e dt.15.02.2021, nr.4/21 e dt. 15.01.2021 të cilat janë në shumë të përgjithshme prej 1,500.00 Euro i plotësojnë në tërësi kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, si dhe është e përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht nr. 120/21 e dt. 15.10.2021, 106/21 e dt. 15.09.2021, 95/21 e dt.16.08.2021, nr.82/21 e dt. 15.07.2021, 67/21 e dt.15.06.2021, 54/21 e dt.15.05.2021, 43/21 e dt.15.04.2021, 30/21 e dt. 15.03.2021, 17/21 e dt.15.02.2021, 4/21 e dt. 15.01.2021, të cilat i

përbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe fakti i pagesës së pjesshme të faturave vërteton pranimin e faturave.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar pjesërisht detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjesërishtme të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbartimor e lë në fuqi, sa i përket pjesës së mbetur prej 640.00 €.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit se kreditori dhe debitori kanë pasur marrëveshje verbale për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit dhe pagesën në kundërvlerë për shërbimet e ofruara, dhe erdhi në përfundim se pretendime të tillë janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësime tjera, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 29, 37 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.975/22, datë 12.06.2023

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.